UDHËZIM
Nr. 223, datë 11.4.2017

PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN, KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKESAVE, PËR SANKSIONET MBI MOSZBATIMIN E MASAVE SHTESË TË SIGURISË PUBLIKE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 7 të nenit 16 të ligjit nr. 19/2016, "Për masat shtesë të sigurisë publike",

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, i cili përbëhet nga:

a) Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit	kryetar
b) Drejtori i Drejtorisë Juridike	anëtar
c) Shefi i Sektorit për Krimet e Pronës	anëtar
d) Shefi i Sektorit të Policimit në Komunitet	anëtar
e) Specialisti në Sektorin ndaj të Tretëve	anëtar.

2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka në kompetencë shqyrtimin e ankimeve të paraqitura nga subjektet publike dhe private, për:

a) gjobat që vendosen nga Policia e Shtetit, ndaj këtyre subjekteve, për moszbatimin e masave shtesë të sigurisë, sipas llojit të masës, në varësi të aktivitetit që kryejnë dhe vlerësimit të rrezikut;

b) heqjen e "Vërtetimit të sigurisë";

sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 4, të nenit 16 të ligjit nr.19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike" dhe të udhëzimit nr.134, datë 10.3.2017 të Ministrit të Punëve të Brendshme "Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit dhe vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre".

3. Ankimet e subjekteve publike dhe private administrohen nga specialisti në sektorin ndaj të tretëve, i cili relaton në mbledhjen e komisionit.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave mblidhet me kërkesën e kryetarit.

5. Subjekti që paraqet ankim, ka të drejtë të përfaqësohet dhe të depozitojë ankimin dhe dokumentacionin e nevojshëm, para Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor, të autorizuar prej tij.

6. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave shqyrton ankimin brenda 30 ditëve nga depozitimi i tij.

7. Subjekti njoftohet për datën e shqyrtimit të ankimit, sipas formave të njoftimit të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit dhe dëgjimit të subjektit ankues, Komisioni merr vendim me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

8. Në rast se ndonjë nga anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, ka pengesë ligjore për ushtrimin e detyrës, sipas rasteve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, ai zëvendësohet me urdhër të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

9. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar.

10. Ngarkohet Drejtoria e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj